

Në lidhje me kontratat e lidhura bëjmë me dije se çdo procedurë prokurimi, e cila ka statusin e realizuar, nënkupton se është në fazën e zbatimit, që do të thotë se janë lidhur kontratat me operatorët ekonomikë të shpallur fitues. Pasi përfundon afati i zbatimit të kontratës, nis plotësimi i formularit të raportimit të kontratës, sipas modelit të lëshuar nga APP. Kontratat që ka firmosur SHRUKF janë të gjitha 12-mujore për këtë vit dhe për momentin nuk ka informacion të gatshëm për monitorimin e tyre.